Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-471 Datë: 29.05.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 merr:

V E N D I M

I. **NUK Riakreditohet dhe Rivalidohet** Instituti Profesional ATC SH.P.K me adresë: Rr. UÇK, Nr. 5, 10.000 Prishtinë, për kualifikimet e shkurtra sipas standardeve të profesionit:

1. **Instalues Ujësjellësi dhe Kanalizimi, Niveli III i KKK,** lloji: Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) me pesëmbëdhjetë (15) kredi të IAAP.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Me datë: 19.02.2026 Instituti Profesional ATC, ka parashtruar kërkesë në AKK Nr.prot.01-86, për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin **Instalues Ujësjellësi dhe Kanalizimi, Niveli III i KKK,** lloji: Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) me pesëmbëdhjetë (15) kredi të IAAP. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimin si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit për kualifikimin ka realizuar vizitën me datë 09.02.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësuese raportet janë dorëzuar me datë 03.03.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 29.05.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve, aplikacionet për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave të realizuara tek pala aplikuese.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 KD ka shqyrtuar kërkesën në mënyrë të detajuar ku dhe është konstatuar se sipas akteve nënligjore në fuqi: Riakreditimi me kusht i institucionit ATC për kualifikimin: **"Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit",** nuk ka bazë ligjore.

Akreditimi me kusht parashihet vetëm si fazë fillestare, kurse riakreditimi me kusht nuk ekziston si kategori ligjore dhe cenon procesin e sigurimit të cilësisë.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, duke u mbështetur në kompetencat ligjore dhe diskrecionin në vendimmarrje, ka vlerësuar se, pavarësisht rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të paraqitura në raportet e vlerësimit për riakreditim dhe rivalidim, si dhe gjetjeve të evidentuara në raportet e vlerësimit që sugjerojnë riakreditim me kushte, një vendim i tillë nuk gjen mbështetje në kuadrin rregullativ dhe ligjor të AKK-së që rregullon procedurat e akreditimit/riakreditimit dhe rivalidimit të institucioneve dhe programeve në nivelin përkatës.

Si rrjedhojë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

- *Instituti Profesional ATC*
- *Arkivit të AKK.*

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve